



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1083\_01\_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 10.02.2014.

**në seancën e mbajtur më datë 12 mars 2014, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin F.I., me shifër të konsumatorit: DPR – 9038870) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1083\_01\_14 i datës 13.01.2014.

**Arsyetim**

Me datë 07.03.2007 konsumatori ka bërë kërkesë në KEK me të cilën ka kërkuar që t'i bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik.

Me datë 29.03.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 22102236 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 39520460, ku kanë theksuar se ky njehsor duhet të shkoj në shqyrtim dhe verifikim.

Me datë 06.04.2007 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 22102236, ku është konstatuar se njehsori elektrik (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar nga ana e jashtme dëmtime nuk ka, numëruesi është i manipuluar.

Nga qendra e kalibrimit është lëshuar edhe procesverbali i shqyrtimit të njehsorit elektrik, ku është theksuar se njehsori është i dëmtuar, bulonat e bllombave janë të çelur, numëruesi i manipuluar etj.

Me datë 14.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut, për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatori, ku kanë konstatuar se në bazë të procesit të kalibrimit kemi dal në vend për të marr seksionin e kabllit furnizues.

Me datë 16.07.2008 Departamenti i Faturimit në KEK e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06264 në vlerë prej 4,354.45€.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 15.09.2008 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së



konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 13.01.2014 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: KKDFE duhet të shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06264 të datës 16.07.2008 në vlerë prej 4,354.45 €.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës dhe se janë cenuar rend dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Administrative. Përkatësisht neni 17 paragrafi 1 ku theksohet: *“Në rast kur vendimi përfundimtar në procedim administrativ kushtëzohet nga marrja e një vendimi paraprak, i cili, nga ana e tij, është në kompetencë të një organi tjetër të administratës publike ose të gjykatës, organi që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar pezullon procedimin administrativ derisa organi tjetër ose gjykata të marrin vendimin paraprak”*.

Pika tjetër e kundërshtimit nga ana e KEDS ka qenë se lidhur me këtë çështje KEDS ka parashtruar padi në gjykatën kompetente për kompensim dëmi të shkaktuar nga konsumatori për vlerën prej 4.354.45€.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 mars 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara, si dhe pretendimi tjetër se gjatë vendosjes së kësaj çështje janë cenuar rënd dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Administrative, përkatësisht neni 17 paragrafi 1 të këtij ligji.

Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës e posaçërisht procesverbalit të kalibrimit dhe rrjedhës së energjisë elektrike ka vërejtur se konsumatori nuk ka indikacione të rritjes së shpenzimit të energjisë elektrike nëse krahasojmë periudhat kohore me njehsor të vjetër dhe me njehsor të ri. Edhe për kundër faktit që ky konsumator para periudhës së ndërrimit të njehsorit elektrik nuk ka pasur një faturim të rregullt të energjisë elektrike, pasi që rrjedha e energjisë elektrike tregon se ky konsumator në shumë raste ka zero shpenzim (kilovatorë –kWh) të evienduntuar. Po ashtu edhe në dokumentet e KEK-ut si, rrjedha e energjisë aktive, procesverbali i ndërrimit të njehsorit elektrik numri i njehsorit elektrik të vjetër ka qenë 22102236, përderisa në procesverbalin e kalibrimit dhe fotografitë e kalibrimit numri i njehsorit elektrik ka qenë 22102238. Kjo ka mundur të jetë edhe ndonjë gabim teknik nga ana e punëtorëve të KEK-ut me rastin e regjistrimit të konsumatorit në programin e faturimit.

Sipas procesverbalit të kalibrimit është thënë se njehsori elektrik bllobat shtetërore i ka të manipuluar nga ana e jashtme dëmtime nuk ka, numëruesi është i manipuluar. Bazuar në këto dëshmi janë kërkuar nga qendra e kalibrimit fotografit për njehsorin elektrik nr. 22102236 për të vërtetuar se a qëndrojnë konstatimet e tilla apo jo, mirëpo nga ajo që shihet në këto fotografi nuk ka ndonjë element që vërteton faktin se njehsori elektrik është manipuluar dhe se nuk shihet se si është manipuluar numëruesi. Sipas neni 8 paragrafi 8.3 të Rregullës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike theksohet: *“Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur”*.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit nga ana e KEDS, se DMK e ZRRE-së, ka shkelur dispozitat e neni 17 paragrafi 1 të LPA-së pasi që lidhur me këtë çështje ndaj këtij konsumatori është zhvilluar procedurë penale dhe është dënuar nga gjykata me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale vjedhje nga neni 252 paragrafi 1 i KPK-së. Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të edhe kësaj pike ka konstatuar se vendimi i DMK-së është nxjerr në përputhje të plotë me Rregullën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, pasi që kjo rregull i ka dhënë të drejtë ligjore që



konsumatori të parashtrojë ankesë në DMK, duke kundërshtuar faturën e rikthimit të humbjeve, andaj mbi bazën e kësaj DMK ka vendosur në përputhje të plotë me këtë rregull.

Sa i përket çështjes tjetër të ngritur në ankesë se KEDS ka parashtruar padi në gjykatë për kompensim të dëmit, ZRRE nuk ka qenë e informuar dhe nuk ka pranuar asnjë dokument lidhur me këtë çështje që dëshmon faktin se e njëjta ka bërë padi, gjithashtu vendosja e kësaj çështje ka qenë në përputhje të plot me dispozitat e lartcekura.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.03.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1083\_01\_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar